

Programi i sociologjisë

A dëshiron të dijshë më tepër se si janë zhvilluar njërëzit dhe shoqëria?

A dëshiron të vazhdosh studimet pas gjimnazit?

A dëshiron një shkollim të gjërë gjimnazial?

A dëshiron të ushtrohesh të mendosh në menyrë shkencore dhe të shkruajsh dhe të flasish?

A dëshiron të i zhvillosh aftësitë e bashkëpunimit me të tjerët?

Atëherë, Programi i sociologjisë mund të jetë për ty.

Te Programi i sociologjisë studion lëndë siç është historia, sociologji, gjuhë dhe ekonomi. Programi të jep dituri të gjëra për të vazhduar studimet në universitet dhe fakultet.

Do të ushtrosh të përdorësh gjuhën tënde në mënyra të ndryshme. Do të shkruajsh shumë dhe dot ë flasish në praninë e të tjerëve. Ke poashtu edhe mundësi të mira që të mësosh shumë gjuhë tjera përveç suedishtes. Mund t'i keni dyert e hapura për studime dhe punë në të gjithë botën.

Të punosh apo t'i vazhdosh studimet

Programi i sociologjisë të pregadit fillimisht për vazhdim të studimeve. Pas gjimnazit ke kompetencë që të kërkosh të pranohesh në shumë kualifikime nepër fakultete dhe univesitete.

Punë ku mund të pranohesh

Mvarrësisht se çka zgjedh të studiosh pas gjimnazit, në ardhmëri mund të kërkosh punë brenda shumë lëmive. Shembull i lëmive është juridika, akonomia, sociologjia, shkencat e sjelljes, lëndët humane dhe profesionet e arsimit. Nëse që tani e di se me çka dëshiron të punosh ose se ne cilin shkollim dëshiron të pranohesh, mund të pyesni udhërrëfyesin e studimeve dhe të profesioneve se cilin drejtim dhe cilat kurse do të duhet t'i zgjedhësh.

Përmbajtja e programit

Programi i sociologjisë përbëht prej kurseve. Disa kurse janë obligatorike për të gjithë ata që studiojnë në gjimnaz. Kurset e tjera janë të posaçme për Programin e sociologjisë. Disa kurse i zgjedh ti vetë.

Programi përbëhet prej katër drejtimeve kombëtare. Kjo do të thotë se të gjithë ata që studiojnë Programin e Sociologjisë në tërë vendin mund t'i zgjedhin drejtimeet. Në disa vende mund të ketë edhe më tepër drejtime që ndoshta të përshtaten ty më së miri. Pyete udhërrëfyesin tënd të studimeve dhe të profesioneve.

Drejtimet kombëtare janë:

- Ekonomia- me lëndë siç janë ekonomia tregtare, dituri juridike, ekonomi ndërkombëtare, informacion dhe layout
- Kulturë – për ty që për shembull dëshiron të studiosh histori kulturore dhe ideatore, dituri fetare dhe literaturë

- Sociologji – për ty që dëshiron të mesosh histori, sociologji, filozofi dhe dituri fetare
- Gjuhë – për ty që dëshiron të mësosh gjuhë tjera përveç anglishtes

Kontaktet me tregun e punës

Kualifikimi në vende të punë (APU) nuk është pjesë e Programit të sociologjisë, por mund të ketë mundësi për ty që të pranohesh në një apo disa vende pune gjatë kohës së gjimnazit. Kjo varret nga drejtimi ose nga kurset që i mësoni, por kontaktet personale dhe qëllimet mund të ndikojnë poashtu.

Ardhmëria dhe puna

Janë të shumtë ata që studjojnë lëndët sociologjike në universitete dhe fakultete. Kjo është edhe arsyeja që mund të përbëjë vështërsi që të gjeni punë në idhje me kualifikimin tënd. Ti ke më tepër mundësi që të pranohesh në punë në rast se shkollohesh për ekonomi tregtare ose IT. Pyete udhërrëfyesin tënd të studimeve dhe të profesioneve se cilat janë konditat në lëminë që të intereson ty.